



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 2327/prot

Koplik më: 04/09 / 2025

V E N D I M

Nr 28 datë 03 / 09 / 2025

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e tij të datës 03.09.2025, mbështetur në aktin normativ nr 3 datë 15.03.2020 neni 5, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015. "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9 pika 1.7/a, të Ligjit 94/2022 "PËR TITUJT E NDERIT DHE TITUJT VENDORË TË NDERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" neni 9 pika 1.

VKM Nr.861 datë 10.12.2014 Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë.

VENDOSI

T'i akordojë titullin "Qytetar Nderi" Z. **Petrit Gjinaj** me motivacionin:

"Për punën dhe përkushtimin e tij si një qytetarë bashkëkohorë, si një kontribues në artin e kulturën malësore sidomos në fushën folklorike dhe atë njerëzore humanitare duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe".

1. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Brendshme.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratur me 03.09.2025


Vota Pro 28

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 04.09.2025





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE

Nr. 2327.prot

Koplik më: 27/08/2025

Këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe
Propozim për dhënie titulli “ Qytetarë Nderi “ i Bashkisë Malësi e
Madhe z. Petrit Gjinaj



Petrit Gjinaj është këngëtar i njohur i lindur dhe rritur në Gruemirë, Nj.A.Gruemirë Mbas mbarimit të shkollës 8 vjeçare dhe të mesme në vendlindje e pas ndryshimeve të sistemit do të ishte ndër ata shqiptar që rininë dhe fatin e tij do t'ia besonte detit dhe udhëtimit që do ti ndryshonte jetën. Pasi emigroi në Greqi ai vendos të niset drejt Italisë, vend ku do të ndërtonte jetën e tij personale dhe profesionale si artist. Ai ka arritur që përveç punëve të shumta që ka bërë në shtetin Italian të mbante gjallë edhe ëndrrën për të qenë këngëtarë. Diçka që me kohën do të rritej dhe do të bëhej realitet. Ai ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në promovimin dhe kultivimin e vlerave humane atdhetare. Në të gjithë këto vite ai ka punuar dhe si artist, por edhe si misionar i humanizmit ku vitet e fundit si drejtues i shoqatës “**Ura Bashkimit**” me rezidencë në Itali në bashkëpunim me shumë bashkatdhetarët, ka dhënë një ndihmë të madhe për vendlindjen e tij, sidomos gjatë pandemisë por edhe në vitet në vazhdim.

Për gjitha sa thamë më lartë i propozohet Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe ti jepet titulli “ Qytetarë Nderi “ i Bashkisë Malësi e Madhe me

motivacion:

“Për punën dhe përkushtimin e tij si një qytetarë bashkëkohorë, si një kontribues në artin e kulturën malësore sidomos në fushën folklorike dhe atë njerëzore humanitare duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe”

KRYETAR BASHKIE

TONIN MARINAJ